



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2020:004252

Datë: 18.02.2021

Numri i dokumentit: 01518066

C.nr.68/20

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** përmes gjyqtarit Blerim Beshtica, në çështjen juridike kontestimore të paditësve D.K., E.M.S., E.H., E.K. dhe E.H., të gjithë me vendbanim në Gjilan, të cilën sipas autorizimit i përfaqëson Labinot Buzuku, avokat nga Prishtina, rr. “Mramori” – Hajvali, ndërsa sipas autorizimit bartës i përfaqëson Adnan Pacolli, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Burim Maliqi nga Gjilani, me objekt kontesti për kompenzimin e shpenzimeve për ushqim dhe paga jubilarë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjygjëse, më datën 18.02.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësve D.K., E.M.S., E.H., E.K. dhe E.H., që të gjithë nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit, ashtu që paditësve:

a) D.K., në emër të shpërbilimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës në vlerë prej 100 % të një (1) page bazë, t’ia kompensoj shumën prej 459.00 € dhe në emër të kompensimit të ushqimit gjatë punës për 553 ditë pune (për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 18.12.2020) në shumë prej 1,106.00 €, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,565.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

b) E.M.S., në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës në vlerë prej 50% të një (1) page bazë, t’ia kompensoj shumën prej 229.50 € ( $459 \times 50\% = 229.50$ ) dhe në emër të kompensimit të ushqimit gjatë punës për 553 ditë pune (për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më datë 18.12.2020) në shumë prej 1,106.00 €, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,335.50 €, me kamatë ligjore prej 8% , duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

c) E.H., në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës në vlerë prej 75 % të një (1) page bazë, t'ia kompensoj shumën prej 344.25 € ( $459 \times 75\% = 344.25$ ) dhe në emër të kompensimit të ushqimit gjatë punës për 222 ditë (për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e deri me datë 18.12.2020) shumën prej 444.00 €, respektivisht shumën e përgjithshme prej 673.50 €, me kamatë ligjore prej 8% , duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri ne pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

d) E.K., në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës në vlerë prej 75 % të një page bazë, t'ia kompensoj shumën prej 344.25 € ( $459 \times 75\% = 344.25$ ) dhe në emër të kompensimit të ushqimit gjatë punës për 553 ditë pune (për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 18.12.2020) shumën prej 1,106.00 €, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,450.25 €, me kamatë ligjore prej 8% , duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri ne pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

e) E.H.t, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës në vlerë prej 75 % të një page baze, t'ia kompensoj shumën prej 344.25 € ( $459 \times 75\% = 344.25$ ) dhe në emër të kompensimit të ushqimit gjatë punës për 553 ditë pune (për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 18.12.2020) shumën prej 1,106.00 €, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,450.25 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri ne pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit, që paditësve t' iu paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në shumë prej 857.6 €, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit më dhunë, ndërsa refuzohet pjesa tjetër e paditësve në lidhje me shpenzimet e kërkuara për paraqitjen e precizimit parashtrës në shumë prej 312 €.

### **A r s y e t i m**

Duke pasë parasysh faktin se kërkesëpadia e paditësve ka të bëjë me kompensimin e shpenzimeve për ushqim, shpërblim jubilar, e që kontestet e tilla sipas përmbajtjes së padisë, por edhe sipas praktikës gjyqësore nuk rezultojnë të jenë të komplikuar, gjykata pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës (padinë, përgjigjen në padi dhe provat e bashkëngjitura padisë), me qëllim që gjykimi të jetë sa më efikas dhe ekonomikisht i arsyeshëm, e në përpjekje që procedura gjyqësore të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, dhe duke u bazuar ne nenin 401 e lidhur me nenin 10 par.1 të LPK-së, ka vendosur që mos të konvokoj seancën përgatitore, por që drejtpërdrejt ka caktuar seancën për shqyrtimin kryesor.

### **Pretendimet e palëve ndërgjyqëse:**

Paditësit D.K., E.M.S., E.H., E.K. dhe E.H., të gjithë me vendbanim në Gjilan, nëpërmjet të autorizuarit të tyre Labinot Buzuku, avokat nga Prishtina, rr. “Mramori” – Hajvali, më datën

14.01.2020 kanë paraqitur padi në gjykatë, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e pagave jubilarë dhe kompensimin e ushqimit. Në padi kanë theksuar se të njëjtit janë të punësuar në institucionin arsimor-Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjilan, kurse të njëjtit kanë kontratë pune me kohë të pacaktuar me të paditurën, por e njëjta nuk e ka bërë kompensimin e pagave jubilarë dhe kompensimin për ushqim ditor, ashtu siç e parasheh Kontrata Kolektive e Arsimit e cila ka hyrë në fuqi prej dt.18.04.2017, e konkretisht në nenin 35 pika 8, e po ashtu duke u mbështetur edhe në nenin 8 të LMD-së. Padiësit, nëpërmjet të autorizuarit të tyre kanë dorëzuar parashtrësën e dt.31.12.2020 me të cilin kanë zmadhuar kërkesëpadinë dhe dorëzuar provat materiale në mënyrë që të vërtetohet themelësia e kërkesëpadisë së tyre, andaj nga këto arsye dhe kjo bazë juridike kanë kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija e padiësve dhe të detyrohet e paditura që padiësve t’ia kompensoj kërkesat për shpërblimin jubilar dhe kërkesat për kompensim të ushqimit, e më gjerësisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e padiësve nga arsyet se se padiësi kërkesëpadinë e saj e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës e miratuar dhe nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë (në vijim: MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (në vijim: SBASHK), respektivisht në dispozitat e nenit 35, pika 7 dhe pika 8 e kësaj kontrate, gjersa ka konsideruar se kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Gjilanit si e paditur në këtë rast, sepse kjo kontratë nuk është në fuqi për disa arsye konkrete, pasi që: Ligji Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti i dt.06 Maj 2014 nuk ka paraparë një të drejtë të tillë sipas padisë dhe kërkesëpadisë, dhe se çdo marrëveshje që parasheh të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon efekt juridik. Tutje, ka theksuar se Kontrata Kolektive në hyrje të saj bazohet në Ligjin e Punës i cili nuk parasheh një të drejtë të tillë të beneficioneve, pasi nga neni 77 i këtij ligji potencohet se pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Më tej ka shtuar se pagat jubilarë sipas Kontratës Kolektive të Arsimit mund të realizohen pas çdo 10 viteve dhe se afati i realizimit të kësaj kërkesë është 30 ditë nga koha e të drejtës për kompensim, e në rastin konkret ky afat është tejkaluar në realizimin e kësaj kërkesë, ndërsa nuk ka ndonjë dëshmi se padiësja në afat prej 30 ditësh ka kërkuar realizimin e kësaj kërkesë. Pos të cekurave, e paditura ka konstatuar edhe ditët e pranisë në punë të padiësve, pasi që konsideron se nuk janë vërtetuar me asnjë dëshmi, pasi ditët nuk llogariten sipas ditëve që figurojnë në kalendarin e ditëve të punës që është paraparë në kuadër të MASHT-it, por që ditët e punës duhet të verifikohen në bazë të evidencave të shkollës, ditarëve dhe evidencave elektronike, ndërsa shkollat duhet të lëshojnë dëshmi konkrete, respektivisht vërtetime për ditët e punës. Përveç arsyeve të cekura më lartë, ka shtuar se me nenin 90 pika 8 e Ligjit të Punës, për të qenë kontrata në fuqi ligjore duhet të jetë e regjistruar në MPMS, kurse në rastin konkret kjo kontratë nuk është e regjistruar në organin e lartëcekur. Në fund ka shtuar se nuk janë shterrur mjetet juridike sipas procedurës administrative me qëllim që të inicohet procedura gjyqësore për realizimin e të drejtës së padiësës në afat prej 30 ditësh sipas nenit 79 të Ligjit të Punës, por që kjo kërkesë është vjetëruar, andaj nga këto arsye dhe nga baza juridike e cekur më lartë ka cekur se padija dhe kërkesëpadija e padiësve nuk është e qëndrueshme në aspektin juridik.

Në seancën e mbajtur më datë 21.01.2021, i autorizuari i paditësve, sipas autorizimit bartës, av.Adnan Pacolli ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë, pasi e njëjta është e materializuar me të gjitha provat, duke shtuar se dorëzon precizimin për lartësinë e kërkesëpadisë në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palët, pasi precizimi i dorëzuar paraprakisht nëpërmjet postës është bërë me gabim teknik. Po ashtu, ka hequr dorë nga nxjerrja e ekspertizës së propozuar me padinë fillestare, dhe ka propozuar që të administrohen vetëm provat e bashkëngjitura padisë dhe precizimit të saj. I njëjti ka shtuar se kundërshton pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin për pagat jubilarë, kjo për faktin se e paditura thirret në zbatim të gabuar të drejtës materiale, pasi që as Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, e as Ligji i Punës, kjo ngase këtë çështje e rregullon vetëm Kontrata Kolektive. Në shpjegimin përfundimtar, ka deklaruar se pas administrimit të provave, vërtetohet baza juridike e kërkesëpadisë dhe mbi këtë bazë propozon që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve konform parashtrësës për precizimin e padisë, duke kërkuar kumatën ligjore. I ka kërkuar shpenimet e procedurës kontestimore të precizuara sipas parashtrësës si dhe shpenzimet për taksë në shumën prej 140 euro.

Në po të njëjtën seancë, i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se mbetet pranë përgjigjes në padi, duke kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve. I njëjti ka pranuar padinë e ndryshuar në këtë seancë dhe ka deklaruar se nuk kërkon që seanca të shtyhet për të u deklaruar lidhur me të, mirëpo, ka kundërshtuar të njëjtën vetëm sa i përket bazës juridike. Për paditësit E.M.S., E.H. dhe E.K. konsideron se se kërkesa e tyre sa i përket shpërblimit jubilar në bazë të nenit 353 par.3 dhe nenit 357 par.1 të LMD-së të vitit 2012, si dhe nenit 87 të Ligjit të Punës është e parashkruar, për arsye se të njëjtit kanë mbi 14 (katërmëdhjetë), 19 (nëntëmbëdhjetë) dhe 26 (njëzet e gjashtë) vite përvojë pune, ndërsa dihet se një e drejtë e tillë i ka takuar paditësve pas 10 (dhjetë) dhe 20 (njëzet) vite përvojë pune, që do të thotë se një kërkesë të tillë e kanë bërë pas 4 (katër), 9 (nëntë) dhe 6 (gjashtë) viteve. Gjithashtu, ka theksuar se duke pasë parasysh se shpërblimet jubilarë paguhen më 7 Mars të secilit vit, rrjedhë përfundimi se në atë kohë nuk ka qenë në fuqi asnjë ligj, Kontratë Kolektive apo akt nënligjor që kishte paraparë shpërblimin jubilar për të punësuarit në arsim. Ndërsa, Kontrata Kolektive ku paditësit e bazojnë kërkesëpadinë e tyre nuk parasheh implementim retroaktiv. Tutje, ka shtuar se kontestuese për të paditurën është baza juridike e kërkesëpadisë dhe çështja e parashkrimit të kërkesave për paditësit e lartëcekur, ndërsa nuk është kontestuese përvoja e punës dhe as lartësia e kërkesëpadisë. Në shpjegimin përfundimtar, i njëjti ka deklaruar se mbesin pranë përgjigjes në padi dhe thënieve të deklaruara në këtë seancë, duke shtuar se kjo çështje është e vjetërsuar konform Ligjit të Punës, neni 78, pika 1, ngase paraprakisht ka qenë e nevojshme të shtjerren mjetet administrative, sipas nenit 79 të Ligjit të Punës që parasheh afatin prej 30 ditëve dhe nenit 82 të të njëjtit ligj që specifikon Inspektoriatin e Punës, ashtu që kjo padi është jo lëndore. Pos tjerave, ka kërkuar nga gjykata që ditët e punës pas datës 18.04.2020, do të thotë skadimit të Kontratës Kolektive të mos llogariten si ditë pune dhe rrjedhimisht ti refuzohet kërkesa për këtë pjesë. Po ashtu, i ka kundërshtuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore të kërkuar në këtë seancë, si dhe shpenzimet në emër të hartimit të parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë nga arsyeja se këto shpenzime nuk bëjnë pjesë në shpenzimet e domosdoshme të procedurës, pasi që, i autorizuari i paditësve është person profesionist dhe padinë ka mund ta precizojë menjëherë, me një parashtrësë inicuese.

## **Provat e administruara në shqyrtimin kryesor :**

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: Listën e pagesave, me nr. BL8785 të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, me kodin 10-94989-651-0922 për nëpunësit: D.K., E.M.S., E.H., E.K. dhe E.H.; Vërtetimin për përvojën e punës, me nr. protokollin 470/19 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjiilan për D.K., më datën 10.12.2019; Kontratën e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, me nr.protokollin 216, të datës 01.09.2017 për D.K.; Kartelën e SBASHK për E.M.; Vërtetimin për përvojën e punës, me nr. protokollin 194/19 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjiilan për E.M., më datën 10.12.2019; Kontratën e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, me nr.protokollin 516, të datës 01.09.2019 për E.M.; Vërtetimin për përvojën e punës, me nr. protokollin 449/19 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjiilan për E.H., më datë 10.12.2019; Kontratën e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, me nr.protokollin 25, të datës 01.09.2017 për E.H.; Vërtetimin për përvojën e punës, me nr.protokollin 469/19 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjiilan për E.K., më datë 10.12.2019; Kontratën e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, me nr.protokollin 2109, të datës 01.09.2016 për E.K.; Ekstraktin nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile, me numër serik E 24108085 për E.H., i lëshuar më datë 05.12.2019; Vërtetimin për përvojën e punës, me nr. protokollin 468/19 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjiilan për E.H., më datën 10.12.2019; Kontratën e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, me nr.protokollin 2110, të datës 01.09.2016 për E.H.; Vërtetimin për ditët e pranisë në punë, me nr.protokollin 681/20 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” për D.K., më datë 18.12.2020; Vërtetimin për ditët e pranisë në punë, me nr.protokollin 680/20 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” për E.M.S., më datën 18.12.2020; Vërtetimin për ditën e pranisë në punë, me nr.protokollin 678/20 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” për E.H., më datën 18.12.2020; Vërtetimin për ditët e pranisë në punë, me nr.protokollin 679/20 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” për E.K., më datën 18.12.2020, dhe Vërtetimin për ditët e pranisë në punë, me nr.protokollin 682/20 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” për E.H., më datë 18.12.2020.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, konform dispozitës së nenit 8, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK), erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Në bazë të Listës së pagesave, me nr. BL8785 të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, me kodin 10-94989-651-0922 për nëpunësit D.K., E.M.S., E.H., E.K. dhe E.H., gjykata ka vërtetuar faktin se D.K. realizon pagë mujore neto në shumë prej 594.92 €, ndërsa paga bazë e së njejtës është shuma prej 459 €; E.M.S. realizon pagë mujore neto në shumë prej 897.53 €, ndërsa paga bazë e së njejtës është shuma prej 459 €; E.H. realizon pagë mujore neto në shumë prej 246.96 €, ndërsa paga bazë e të njejtës është shuma prej 459 €; E.K. realizon pagë mujore

neto në shumë prej 581.12 €, ndërsa paga bazë e të njejtit është shuma prej 459 €; E.H. realizon pagë mujore neto në shumë prej 571.92 €, ndërsa paga bazë e të njejtit është shuma prej 459 €.

Në bazë të Kontratës së punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, me nr. protokollin 216, të datës 01.09.2017 për D.K., gjykata ka vërtetuar faktin se e njëjta është punësuar në Gjimnazin Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjiilan, me dt.01.09.2017, në pozitën e mësimdhënëses së lëndës së Biologjisë.

Në bazë të Vërtetimit për përvojën e punës, me nr. protokollin 470/19 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjiilan për D.K., me dt. 10.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se e njëjta ka filluar të punojë tek Gjimnazin “Zenel Hajdini” në Gjiilan me dt.01.09.1987 deri me dt.31.08.2014, kurse në Gjimnazin Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjiilan, ka filluar të punojë nga dt.01.09.2014 e deri me datën 10.12.2019, dhe gjithsej ka 32 vite përvojë pune.

Në bazë të Vërtetimit për ditët e pranisë në punë, me nr.protokollin 681/20 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” për D.K., më dt. 18.12.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se për vitin shkollor 2017-2018, 2018-2019 ,2019-2020 dhe 2020-2021, e njëjta ka të kaluara 553 dite punë, në vendin e saj të punës.

Në bazë të Kartelës së lëshuar nga SBASHK për E.M., gjykata ka vërtetuar faktin se e njëjta është anëtare e SBASHK-ut.

Në bazë të Kontratës së punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, me nr.protokollin 516, të dt. 01.09.2019 për E.M., gjykata ka vërtetuar faktin se e njëjta është punësuar në Gjimnazin Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjiilan, me dt.01.09.2017, në pozitën e mësimdhënëses e lëndëve të Matematikës, Fizikës dhe TIK-ut.

Në bazë të Vërtetimit për përvojën e punës, me nr. protokollin 194/19 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjiilan për E.M., më datë 10.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se e njëjta ka përvojë pune prej 14 vite.

Në bazë të Vërtetimit për ditët e pranisë në punë, me nr.protokollin 680/20 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” për E.M.-Sulçevsi, më datë 18.12.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se për vitin shkollor 2017-2018, 2018-2019 ,2019-2020 dhe 2020-2021, e njëjta ka të kaluara 553 dite punë, në vendin e saj të punës.

Në bazë të Kontratës së punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, me nr.protokollin 25, të dt. 01.09.2017 për E.H., gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti është punësuar në Gjimnazin Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjiilan, me dt.01.09.2017, në pozitën e mësimdhënësit të lëndëve të Historisë.

Në bazë të Vërtetimit për përvojën e punës, me nr. protokollin 449/19 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjiilan për E.H., më datë 10.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti ka 20 vite përvojë pune.

Në bazë të Vërtetimit për ditët e pranisë në punë, me nr.protokollin 678/20 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” për E.H., më dt. 18.12.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se

për vitin shkollor 2017-2018, 2018-2019,2019-2020 dhe 2020-2021, i njëjti ka të kaluara 222 ditë pune.

Në bazë të Kontratës së punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, me nr.protokolli 2109, të dt.01.09.2016 për E.K., gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti është i punësuar në Gjimnazin Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjilan, me dt.01.09.2016, në pozitën e mësimdhënësit të lëndëve të Gjuhës Shqipe.

Në bazë të Vërtetimit për përvojën e punës, me nr.protokolli 469/19 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjilan për E.K., më datë 10.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti ka 27 vite përvojë pune.

Në bazë të Vërtetimit për ditët e pranisë në punë, me nr.protokolli 679/20 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” për E.K., më datë 18.12.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se se për vitin shkollor 2017-2018, 2018-2019,2019-2020 dhe 2020-2021, i njëjti ka të kaluara 553 dite punë, në vendin e tij të punës.

Në bazë të Kontratës së punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, me nr.protokolli 2110, të dt. 01.09.2016 për E.H., gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti është punësuar në Gjimnazin Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjilan, me dt.01.09.2016, në pozitën e mësimdhënësit të lëndëve të Kimisë.

Në bazë të Vërtetimit për përvojën e punës, me nr. protokollit 468/19 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjilan për E.H., më dt.10.12.2019, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti ka 22 vite përvojë pune.

Në bazë të Vërtetimit për ditët e pranisë në punë, me nr.protokolli 682/20 të lëshuar nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” për E.H., më dt.18.12.2020, gjykata vërtetoi faktin se se për vitin shkollor 2017-2018, 2018-2019 ,2019-2020 dhe 2020-2021, i njëjti ka të kaluara 553 dite punë, në vendin e tij të punës.

### **Baza juridike:**

Me nenin 90 të Ligjit të Punës, është paraparë se: *1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive; 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”, ndërsa me nenin 4 parag.2 të po këtij ligji, është paraparë se: “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”. Me nenin 245 të*

Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD) në mënyrë të qartë është përcaktuar se: “Kreditori në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Sipas nenit 35 parag.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, të nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është paraparë se: “Punonësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i pagihen shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban”, ndërsa me nenin 35 parag.7 të kësaj Kontrate, parashihet se: “*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarëve, përmes restaurantit a kuzhinës, osë në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit*”, e po ashtu, sipas nenit 35 parag. 8 të kësaj Kontrate, është paraparë se: “*Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë prej: për 10 vite të përvojës së punës në vlerë prej 50 % të një page bazë; për 20 vite të përvojës së punës në vlerë të 75 % të një page bazë; për 30 vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, si dhe për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë*”. Sipas pikës 8.5 të po këtij neni, është përcaktuar se “*Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit i ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse*”, ndërsa sipas pikës 8.6 të këtij neni ndër të tjera parashihet se: “*Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti*”.

### **Vlerësimi përfundimtar i gjykatës:**

Gjykata konstaton se në këtë çështje kontestimore në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese përvoja e punës së paditësve dhe lartësia e kërkesëpadsisë së paditësve, mirëpo, si kontestues për palën e paditur është baza juridike e kërkesëpadsisë, pasi që e paditura konsideron se nuk është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit nga fakti se e njejtja nuk është kontratuese, fakt ky i parashtruar në përgjigje në padi. Po ashtu, në këtë çështje kontestimore nga paditura është ngritur çështja e parashkrimit të kërkesëpadsisë së paditësve E.M.S., E.H. dhe E.K..

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhë në përfundim se kërkesëpadsia e paditësve është e bazuar dhe të njëjten e ka aprovuar në tërësi si të bazuar, pasi që gjykata nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se paditëses D.K.t, në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës i takon kompensimi në vlerë të një (1) page bazë në shumë prej 459.00 dhe në emër të kompensimit të ushqimit gjatë punës për 553 ditë pune (për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 18.12.2020) i takon shuma prej 1,106.00 €; paditësës E.M.S., në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës i takon kompensimi në vlerë prej 50% të një (1) page bazë, edhe atë shuma prej 229.50 € dhe në emër të ushqimit gjatë punës për 553 ditë pune (për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 18.12.2020) i takon kompensimi në shumë prej 1,106.00 €; paditësit E.H.t, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës i takon kompensimi në vlerë prej 75 % të një (1) page bazë në



shumë prej 344.25 € dhe në emër të ushqimit gjatë punës për 222 ditë (për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e deri me datë 18.12.2020) i takon kompesnimi në shumë prej 444.00 €; paditësit E.K.t, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës i takon kompensimi në vlerë prej 75 % të një page bazë në shumë prej 344.25 € dhe në emër të ushqimit gjatë punës për 553 ditë pune (për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 18.12.2020) i takon kompensimi në shumë prej 1,106.00 €, si dhe paditësit E.H.t, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës i takon kompensimi në vlerë prej 75 % të një page bazë në shumë prej 344.25 € dhe në emër të kompensimit të ushqimit gjatë punës për 553 ditë pune (për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 18.12.2020) i takon kompensimi në shumë prej 1,106.00 €, ngaqë këto kompensime janë të parapara në Kontratën Kolektive të Arsimit, të hyrë në fuqi më datën 18.04.2017, të cilat e paditura ka pasë për obligim të i përmbushë dhe duke qenë se e njëjta nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar, gjykata ka vendosur si në pikën I të këtij dispozitivi.

Gjykata në lidhje me pretendimin e të paditurës sa i përket shfrytëzimit të mjeteve sipas procedurës administrative dhe juridike para se të paraqitet padia, gjeti se ky pretendim është i pabazuar për arsye se e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventat ndërkombëtare dhe me ligj, dhe në rastet e paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës - Ligji nr. 03/7-212 i cili është aktualisht në fuqi dhe i cili ka dispozitë prekluzive lidhur me kërkesat në para duke theksuar se: *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ku nga kjo dispozitë del pa mëdyshje se afati për ngritjen e padisë lidhur me kërkesat në të holla-para është afati 3 vjeçar dhe parashtrimi i padisë në gjykatë pas këtij afati është kërkesë e parashkruar.

Pretendimet e përfaqësuesit të palës së paditur, se kërkesëpadia e paditësve për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe të shpërblimit jubilar në lartësi prej 50 %-75 %-100 %, të një page bazë, është në tërësi e pa bazuar dhe e njëjta të refuzohet si e tillë, për faktin se paditësit me asnjë provë nuk kanë arritur të vërtetojnë kërkesëpadinë e tyre, për gjykatën këto pretendime nuk qëndrojnë, për faktin se me nenin 2 të Kontratës Kolektive të lartëcekur, të gjitha Drejtoritë Komunale të Arsimit në Kosovë janë të obliguara të zbatojnë Kontratën Kolektive të Arsimit dhe me kohë të planifikojnë mjete buxhetore për këto raste, ndërsa me nenin 6, paragrafi 4, pika 2 e kësaj Kontrate Kolektive vërtetohet se paditësit bëjnë pjesë në kuadrin e përfituesve të të drejtave që rrjedhin nga kjo Kontratë Kolektive, andaj, edhe përgjegjësia për kompensim të shpenzimeve për ushqim dhe të shpërblimit jubilar për përfituesit është tek e paditura, respektivisht tek DKA në Gjilan.

Po ashtu, gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurës ku është thirrë në parashkrim të kërkesës se paditësve, mirëpo, sipas gjykatës një pretendim i tillë nuk qëndron sepse paditësit: D.K. i ka mbushur 32 vite përvojë pune në vitin 2019; E.M.-Sulçevsi i ka mbushur 14 vite përvojë pune në vitin 2019; E.H. i ka mbushur 20 vite përvojë pune në vitin 2019; E.K. i ka

mbushur 27 vite përvojë pune në vitin 2019 dhe E.H. i ka mbushur 22 vite përvojë pune në vitin 2019, e që në këtë kohë nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar, prandaj paditësit nuk kanë pasur bazë ligjore për parashtrimin e një kërkesë të tillë, kurse padinë me kërkesat e tyre në gjykatë e kanë paraqitur me datën 14.01.2020, çka do të thotë se në afatin e paraparë ligjor konform dispozitave të nenit 87 i Ligjit të Punës i cili në mënyrë shprehimore ka paraparë se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, për më tepër Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar ka hyrë në fuqi me dt.18.04.2017 dhe në bazë të kësaj paditësit nuk kanë mundur ta ushtrojnë këtë kërkesë pasi që para kësaj date nuk ka qenë në fuqi kjo kontratë dhe e njëjta prodhon efekt nga momenti i nënshkrimit të saj.

Po ashtu për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës se Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar nuk prodhon efekt për të paditurën, ngase një pretendim i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës me nr.03/L-068, ku në nenin 5 të këtij ligji janë të parapara kompetencat e komunave sa i përket punësimit të mësimdhënësve dhe pagesës së tyre, e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me Kontratë bien në barrë të të paditurës. *Pos tjerash, gjykata konsideron se një pretendim i tillë është i pabazuar edhe nga fakti se KKAK është lidhur në nivel vendi sipas dispozitave të Ligjit e Punës (nenin 90 i këtij Ligji)*, e po ashtu, edhe me dispozitën e nenit 2 të KKAK-së, është paraparë se dispozitat e KKAK janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha Institucionet e Arsimit Parauniversitar ku bëjnë pjesë edhe paditësit. Pastaj, është caktuar qartë, se dispozitat e kësaj Kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit, gjegjësisht komunat- DKA-të, ku në këtë rast janë të paditur (neni 2 i KKAK-së). Prandaj, nga këto arsye, gjykata vlerëson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga KKAK, pasi që kjo kontratë është lidhur në nivel vendi dhe në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit të Punës. Sa i përket pretendimit tjetër të paditurës ku ka theksuar se KKAK nuk është regjistruar fare në faqen MPMS dhe si e tillë nuk duhet të prodhojë efekt juridik, gjykata një pretendim të tillë nuk e mori për bazë, pasi që një pretendim i tillë sipas kësaj gjykate nuk është i bazuar dhe nuk është relevante se a është regjistruar apo jo KKAK në faqen e MPMS, sepse referuar nenit 47 të kësaj Kontrate ku parashihet se pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët, e njëjta regjistrohet dhe depozitohet në MASHT, e jo në ndonjë organ tjetër siç pretendon e paditura, kjo për faktin se kjo kontratë është sektoriale dhe jo e përgjithshme, dhe e njëjta prodhon efekt juridik vetëm për të punësuarit dhe punëdhënësit në sektorin e arsimit (neni 2 i Kontratës). Sido që të jetë, akti i regjistrimit dhe depozitimi i kontratave, sikurse në rastin konkret, KKAK, ka qenë përgjegjësi e karakterit administrativ të organit publik kompetent që të njejtën ta regjistrojë apo depozitojë, e për të cilat lëshime eventuale nuk mund të kenë konsekuenca të punësuarit, në këtë rast paditësi.

Sipas nenit 245 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD) në mënyrë të qartë është përcaktuar se: *“Kreditori në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. Nga gjendja faktike e vërtetuar dhe në bazë të dispozitave ligjore të cekura më lartë, duke pas parasysh faktin se paditëseve i ka lindur e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtave të tyre lidhur me

kërkesat e parashtruara, të njëjtit si palë e legjitimuar që të kërkojnë përmbushjen e detyrimit nga e paditura gjykata vlerësin se e paditura pasi që, sipas nenit 245 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD) në mënyrë të qartë është përcaktuar se: “Kreditore në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësve, me aplikimin e dispozitës së lartëcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyrojë të paditurën që paditëseve t’ia kompensoj shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën e llogaritur nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore duke u mbështetur në nenin 449 dhe 452, paragrafi 1, të LPK-së, dhe e detyrojë të paditurën, që paditësve t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 857.6 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 312 €; në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë shumën prej 140 € dhe në emër të përfaqësimit në seancën e shqyrtimit kryesor shumën prej 405.60 €, ndërsa refuzoi pjesën tjetër për paraqitjen e precizimit parashtrës në shumë prej 312 €, bazuar në nenin 453 par.1 të nenit të lartëcekur, pasi që i njëjti ka mundur të precizojë padinë e tij në seancën për shqyrtimin kryesor dhe gjykata nuk e pa si shpenzim të nevojshëm për ndjekjen e çështjes në gjyq.

Duke u bazuar në të lartëcekurat, si dhe në dispozitën e nenit 143, të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**C.nr. 68/20, i datës 18.02.2021**

**Gjyqtari,**  
**Blerim BESHTICA**

**UDHËZIMI JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.